



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 23, datë 11.06.2025

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË SHPËRNDARJES SË SUBVENCIONIMIT
PËR OPERATORËT E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK QYTETAS NË
BASHKINË Durrës**

Në zbatim të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54, nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, të ndryshuar, Udhëzimit nr.3743, datë 10.7.2017, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve, të ndryshuar, VKB-së nr. 590, datë 11.03.2019, “Për miratimin e ndryshimit të VKB- nr.233, datë 16.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e procedurës së shpërndarjes së subvencionimit për operatorët e shërbimit të transportit publik qytetas në Bashkinë Durrës.

2. Miratimin e kompensimit nga ana e Bashkisë Durrës të vlerës 10 lekë nga vlera totale e çmimit të biletës 40 lekë.
3. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027”.
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 102, datë 28.10.2024 “Për miratimin e procedurës dhe formulës së shpërndarjes së subvencionimit për operatorët e shërbimit të transportit publik qytetas në qytetin e Durrësit” shfuqizohet.
5. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike si dhe operatorët e transportit publik qytetës në Bashkinë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 16.06.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 402/14 prot.

Durrës, më 18.06.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.23 datë 11.06.2025 ,” Për miratimin e procedurës së shpërndarjes së subvencionimit për operatorët e shërbimit të transportit publik qytetas në Bashkinë Durrës.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

